



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.224/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Lokale, të datës 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 17.10.2025, merr këtë:

VE N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa ZL.A.nr.224/2025, e datës 16.10.2025, e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Lokale, të datës 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 16.10.2025, PZAP-i, përmes postës ka pranuar një ankesë nga Alajdin Troni vëzhgues nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK, në të cilën pretendon se më 12.10.2025 rreth orës 16:37, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Kaçanik Burim Zharku, në vendvotimin 0720 në Kovagec, ka biseduar me kandidatët dhe komisionarët e subjektit të tij LVV. Këto veprime në bazë të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, janë të ndaluara, dhe se me këto veprime i njëjti ka ndikuar tek votuesit.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LVV, sqaron se në ankesën e paraqitur nga z. Ajedin Troni, në emër të subjektit politik PDK, pretendohet se kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje! për asamble në Komunën e Kaçanikut, z. Burim Zharku, më datë 12.10.2025 rreth orës 16:37 ka qëndruar në vendvotimin në fshatin Kovagec, ku thuhet se ka zhvilluar biseda me komisionarët dhe vëzhguesit e subjektit të tij, duke u cilësuar 100 si ndikim në procesin zgjedhor.

Ky pretendim është i paqëndrueshëm si në aspektin faktik ashtu edhe në atë ligjor, Qëndrimi në ambientet e jashtme të objektit të vendvotimit, për një kohë të shkurtër dhe pa ushtruar ndikim mbi votuesit, nuk përbën shkelje të dispozitave zgjedhore.

Sipas nenit 8, paragrafi 1.1 dhe 1.3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës dhe Deklarimin Financiar, ndalohet mbajtja e takimeve apo grumbullimi i përfaqësuesve të subjekteve politike në afërsi të qendrave të votimit me qëllim të ndikimit tek votuesit. Në rastin konkret, nuk ekziston asnjë provë që kandidati ka kërkuar mbështetje, ka shpërndarë materiale fushate apo ka ndërhyrë në procesin e votimit.

Gjithashtu, Rregullorja Nr. 12/2024 për Votimin, Numërimin në Vendvotim dhe Menaxhimin e Vendvotimit, në nenin 6 paragrafi 4 përcakton se vetëm në rast të pengimit të procesit apo cenimit të rendit publik, kërkohet ndërhyrja e Policisë. Në këtë rast, nuk rezulton se është kërkuar ndërhyrje nga autoritetet apo se është ndërprerë procesi i votimit.

Më tej në përgjigje theksohet se në mungesë të çdo prove që dëshmon ndikim mbi votuesit ose shkelje të fshehtësisë së votës, pretendimi nuk përmbush as kriteret e nenit 119 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, sipas të cilit PZAP vendos vetëm kur faktohet një shkelje që ka ndikuar në integritetin e procesit.

Në përfundim, Lëvizja Vetëvendosje! vlerëson se prezenca e kandidatit në hapësirat e jashtme të objektit nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore, pasi nuk është zhvilluar aktivitet fushate, nuk është cenuar procesi i votimit dhe nuk është ndikuar vullneti i lirë i votuesve, Ankesa, rrjedhimisht, në mungesë të provave bindëse dhe në mungesë të qëllimit për ta bërë garën të padrejtë, duhet të refuzohet si e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

-Ankesa është e pa bazuar.

Në bazë të provave të bashkangjitura shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë, paneli vlerësoi se pretendimet ankimore se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Kaçanikut Burim Zharku nga subjekti politik LVV-se i njëjti në vendvotimin 0720 ka biseduar me komisioner të subjektit të tij politik duke ndikuar tek votuesit, nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime janë ndërmarr nga subjekti politik LVV, kundër të cilit është paraqitur ankesa, dhe për të ardhur në përfundim se është bërë shkelje nenit 37 paragrafi 1 1. *Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit;*

Kështu që paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, dëshmitë e ofruara nuk janë të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se subjekti politik PDK, ka bërë fushatë në ditën e zgjedhjeve me qëllim të ndikimit te votuesit, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese, se subjekti në fjalë ka biseduar me komisionerët për qëllime elektorale, andaj në prani të këtyre rrethanave ankesa është refuzuar si e pabazuar.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të

vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.224/2025 më datën 17.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.